



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 6786 /2022
Data: 22.08.2022

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e shtatë -VII- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 28.07.2022 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: z. **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Bajrush Laçi** (Shef i Zyrës Ligjore), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Informim). Kryesuesi i Mbledhje pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

Mehmet Ballazhi thekson:- të nderuar anëtarë të kuvendit të komunës kryesuesi i kuvendit sot nuk është prezentë në mbledhje për shkak se e ka një rast shëndetësorë në familje, andaj kërkoj që anëtari më i vjetër ta kryeson mbledhje.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2022.
3. Raporti i auditorit të përgjithshëm për Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2021.
4. Plani i veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2021.
5. Kërkesë për rialokim dhe transfer të mjeteve nga kategoritë ekonomike të shpenzimeve kapitale dhe mallra dhe shërbime.
6. Propozim vendim për miratim të projektit të ri kapital.
7. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2022.
8. Raportin financiar për periudhën Janar – Qershor 2022 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
9. Informatë për sektorin e emergjencave.
10. Raport për çështjen e ujit në fshatin Gorancë.
11. Të ndryshme.

Zaim Bela (Anëtari më i vjetër i kuvendit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit) thekson:- për pika e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Zaim Bela (Anëtari më i vjetër i kuvendit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit) thekson:- a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2022.

Zaim Bela (Anëtari më i vjetër i kuvendit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit) thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- buxheti i miratuar për vitin fiskal 2022 është në shumë prej 2,759,758.00 €. Në kategorinë Paga dhe shtesa shpenzimi është në shumë prej 845,636.78€ ose 48.15%, në kategorinë mallra dhe shërbime shpenzimi është në shumë prej 97,003.58 € apo 25.13%, në kategorinë ekonomike shërbime komunale shpenzimi është në shumë prej 29,238.28 € apo 43.19%, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere shpenzimi është në shumë prej 28,532 € apo 35.67%, në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale kemi shpenzuar 49,999.89 € apo 10.99% .Totali i shpenzimit për periudhën Janar - Qershor të vitit 2021 është në shumë prej 1,050,410.53 € apo 38.06 %. Komuna e Hanit të Elezit ka arritur të arkëtoj gjithsejtë 157,791.86 € të hyra vetanake për periudhën Janar- Qershor 2021 apo 41.3% e planit të të hyrave vetanake, ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2021 kemi një rënie prej 34,720.24 € apo për 18%, (duke pasur parasysh që planifikimi i të hyrave për vitin 2022 është në shumë prej 381,347 € ndërsa për vitin 2021 është 288,624 €).

Ajnore Thaçi thekson:- kërkoj sqarim për rënien e të hyrave vetanake dhe për kategorinë e shpenzimeve të varrimit nuk ka pasur asnjë shpenzim.

Hyriete Isufi thekson:- faturat e tatimit në pronë janë shpërndarë pak me vonesë dhe mund të tatimohet me kamat pasi skadimit të afatit të pagesës.

Lindita Ballazhi thekson:- nëse krahasohen me planifikimin e të hyrave që kanë qenë në vitin paraprakë mbi 100 000 € kemi planifikim më të madh në këtë vit dhe nëse krahasohet me të hyrat e viti paraprak i bien që nuk kemi rënie, mirëpo mund të ketë ndikuar rritja e çmimeve. Është bërë pagesa e taksës për ushtrim të veprimtarisë pas gjashtë muajve të parë nga kompania “Sharrcem” që e rrit përqindjen e të hyrave. Në gjashtë muajin e parë nuk janë bërë shpenzime nga kategoria e shpenzimeve të varrimit. Nga Ministria përkatëse dhe nga departamenti i tatimit në pronë kemi marr vendimin që është zgajtur afati i shpërndarjes së faturave të tatimit në pronë, gjithashtu është zgjatur edhe afati i ankesave të tatimit në pronë për këtë arsye nuk ka pasur vonesa.

Zaim Bela (Anëtari më i vjetër i kuvendit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit) thekson:- planifikimi për vitin 2022 ishte në shumë prej 381000 € ndërsa një vit më para ka qenë 285 000 € që do të thotë 100 000 € janë diferencë të hyrat vetanake. Është mirë që tu sqarohet qytetarëve se 20 % e tatimit në pronë për çdo vit është rritur dhe në vitin e pestë e mbërrin kuotën qind për qind. Në disa komuna të Kosovës e kanë publikuar listën e të gjithë të punësuarve të cilët marrin pagë prej buxhetit të komunës dhe që kanë obligime të pa paguara ndaj komunës.

Lindita Ballazhi thekson:- në këtë vit është llogaritur 80 % e vlerës ndërsa në vitin e ardhshëm do të llogaritet qind për qind.

Zaim Bela (Anëtari më i vjetër i kuvendit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit) thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RAPORTI FINACIAR PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2022

3. Raporti i auditorit të përgjithshëm për Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2021.

Zaim Bela (Anëtari më i vjetër i kuvendit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit) thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- në raportin e auditorit të përgjithshëm për Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2021 janë dhënë nëntë rekomandime që prej tyre tetë rekomandime janë të reja dhe një rekomandim është i përsëritur. Klasifikimi i shpenzimeve në kategoritë ekonomike jo përkatëse. Mangësi në shënimet shpjeguese të pasqyrave vjetore financiare. Parregullsi në procedurat e rekrutimit të personelit. Mangësi në vlerësimin e tenderëve. Parregullsi në procedurat e subvencionimit të projekteve. Nënshkrimi i kontratës publike pa zotim paraprak të mjeteve në SIMFK, si dhe lëshimi i urdhër blerjeve pas skadimit të kontratave. Parregullsi në menaxhimin e pasurisë jofinanciare. Rritje e llogarive të arkëtueshme. Vonesa në regjistrim dhe pagesa të obligimeve. Materialin për këtë pikë të rendit të punës e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Resul Suma thekson:- a do të merr dikush përgjegjësi për rekomandimet të cilat janë dhënë nga auditori për shkak se janë bërë gabime prej punëtorëve të cilët janë brenda komunës

Xhevahir Dernjani thekson:- duke pasur parasysh këto nëntë shkelje për këtë komunë kaq të vogël nuk e di çka do të ketë diçka më tepër.

Sherif Berisha thekson:- te lista e pagave a ka punëtorë të cilët punojnë në arsim dhe janë në listë të pagave të komunës apo anasjelltas.

Lindita Ballazhi thekson:- në pikë e radhës i kemi shprehur të gjitha planet të cilat do t'i ndërmarrim për me i realizuar rekomandimet e auditorëve që në vitin e ardhshëm mos me u përsëritur këta të gjetura. Nuk ka raste të atyre që janë pjesë e arsimit dhe pagën e marrin prej administratës komunale.

Zaim Bela (Anëtari më i vjetër i kuvendit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit) thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

4. Plani i veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2021.

Zaim Bela (Anëtari më i vjetër i kuvendit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit) thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- duke pasur parasysh të gjeturat e auditorëve kemi përgatitur një plan për zbatimin e rekomandimeve të cilat na janë dhënë nga zyra e auditorit. Materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Zaim Bela (Anëtari më i vjetër i kuvendit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit) thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraprirë sipas agjendës.

5. Kërkesë për rialokim dhe transfer të mjeteve nga kategoritë ekonomike të shpenzimeve kapitale dhe mallra dhe shërbime.

Zaim Bela (Anëtari më i vjetër i kuvendit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit) thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- rialokimi dhe transferi i mjeteve në kategorinë shpenzime kapitale është në shumë prej 37,695.00 €. Më në detale i keni në material se ku do të rialokohen mjetet financiare. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Zaim Bela (Anëtari më i vjetër i kuvendit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit) thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA KËRKESA PËR RIALOKIM DHE TRANSFER TË MJETEVE FINACIARE NGA KATEGORITË EKONOMIKE TË SHPENZIMEVE KAPITALE DHE MALLRA DHE SHËRBIME

6. Propozim vendim për miratim të projektit të ri kapital.

Zaim Bela (Anëtari më i vjetër i kuvendit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit) thekson:- pasi është projekt dy vjeçar a ekziston mundësi që gjatë planifikimit për vitin e ardhshëm të hynë edhe aksi rrugorë që është jashtë kësaj vije që ka mbetur te Kroj i Staneve pa u asfaltuar për shkak se është traseja dhe me u lidh me këtë rrugën që është te Kroj i Paldenicës. Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- bëhet fjalë për projektin projektit të ri kapital “Ndërtimi i rrugës Ramukë - Kroj i fshatit Paldenicë” në shumë prej 213,000 €. Në këtë vit kemi arritur marrëveshje me Ministrinë e Infrastrukturës për financimin e këtij projekti dhe në këtë vit do të shfrytëzohen 50 000 € për ndërtimin e rrugës, ndërsa pjesa tjetër në vitin 2023. Kërkoj nga ju që të votohet ky projekt për shkak se është në interes të qytetarëve. Aneksi nuk mund të përfshihet për shkak se e kemi dërguar në Ministri dhe kur të bëhen planifikimet buxhetore mund ta propozoni si projekt në kuvend dhe nëse miratohet do të realizohet.

Zaim Bela (Anëtari më i vjetër i kuvendit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit) thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT TË RI KAPITAL

7. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2022.

Zaim Bela (Anëtari më i vjetër i kuvendit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit) thekson:- Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:- kemi mbajtur takime të rregullta dhe me akterët përgjegjës i kemi diskutuar çështjen për te kufiri e që për momentin nuk po mundemi me bërë zgjidh por përmes policisë po e rregullojmë komunikacionin. Është diskutuar edhe çështja e qenve endacak por kjo është çështje e nivelit qendrorë që nuk po mundemi me gjet zgjidhje për shkak se është çështje e nivelit qendrorë.

Zaim Bela (Anëtari më i vjetër i kuvendit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit) thekson:- a keni diskutuar për çështjen e substancave narkotike.

Nora Xhoni thekson:- tash është sezona e dasmave, a është diskutuar çështja e përdorimit të armëve dhe e fishek zjarreve pas orës dymbëdhjetë se është shqetësim për qytetarët.

Mehmet Ballazhi thekson:- çështja e substancave narkotike është diskutuar çdo herë për shkak se ka pasur dyshime por konkrete nuk ka diçka. Çështjen e përdorimit të armëve dhe fishek zjarreve e kemi diskutuar në bord të drejtorëve por në KKSB nuk e kemi diskutuar por nuk kemi pasur ndonjë ankesë për këtë çështje , mirëpo do ta diskutojmë në mbledhje të radhës.

Zaim Bela (Anëtari më i vjetër i kuvendit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit) thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraprirë sipas agjendës.

8. Raportin financiar për periudhën Janar – Qershor 2022 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.

Zaim Bela (Anëtari më i vjetër i kuvendit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit) thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraprirë sipas agjendës.

9. Informatë për sektorin e emergjencave.

Zaim Bela (Anëtari më i vjetër i kuvendit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit) thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Arsim Dernjani thekson:- përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Zaim Bela (Anëtari më i vjetër i kuvendit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit) thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraprirë sipas agjendës.

10. Raport për çështjen e ujit në fshatin Gorancë.

Zaim Bela (Anëtari më i vjetër i kuvendit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit) thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- sa i përket çështjes së ujit e kam përcjell materialin të cilin najë ka përcjell instituti i shëndetit publik . Në raport është e cekur çështja e ujit dhe e pacientëve. Gjatë muajit korrik kemi pasur një numër të shtuar të pacientëve me covid dhe gjithsejtë janë testuar 115 që prej të cilëve 43 raste janë pozitive, 25 riestime të cilat kanë rezultuar negativ dhe aktualisht i kemi 18 raste aktiv. Sa i përket vaksinimit me covid interesimi i qytetarëve është shumë i ulët dhe këtë muaj janë dhënë vetëm katër doza të vaksinimit. Nga muaji prill i vitit 2021 e deri në muajin korrik të viti 2022 janë 9784 doza.

Resul Suma thekson:- si është gjendja me listën e barnave esenciale për shkak se nëse shkon pacienti në QKMF duhet ti blenë barnat duke filluar prej infuzionit e deri te barnat më të rëndë.

Hanumshahe Dibrani thekson:- e dimi që stafi në QKMF është i vogël a ekziston mundësia e rritjes së stafit sepse ka qenë numri shumë i madh me virus.

Sherif Berisha thekson:- për AMF-në në Gorancë bëhen njoftimet për infermieret të cilat janë në trajnim, mirëpo a janë për herë të parë në ato trajnime sepse nuk po më doket mirë që me u mbyll AMF-ja për shkak të trajnimeve.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:-me barna esenciale furnizohemi prej Ministrisë së Shëndetësisë dhe mungesa e barnave esenciale që ka qenë në listë ka qenë për katër vite me radhë. Marrëveshje ka pasur përmes zyrës së prokurimit, mirëpo unë kam kërkuar nga inspektorati farmaceutik se a kam të drejtë ligjore që ta vazhdojë këtë marrëveshje dhe imellën ua kam dërguar por askush nuk e merr këtë përgjegjësi për mënyrën e formës së furnizimit . Për komunën është një hap i lehtë për me i zhvilluar procedurat përmes zyrës së prokurimit dhe me lidh kontratë me një kompani private. Sa i përket shtimit të stafit kemi bërë kërkesë zyrës së prokurimit për me i zhvilluar procedurat për tre infermiere. Trajnimet zakonisht bëhen për zhvillim të

karrierës dhe shëndetësi duhet çdo hap me ndjekë sa i përket trajnimeve se po bëhen ndryshime në shëndetësi sepse po avancohet teknologjia dhe janë trajnime që patjetër duhet të ndiqen . Nuk është se është hera e parë por vazhdimisht kanë trajnime të një pas njëshme.

Zaim Bela (Anëtar i më i vjetër i kuvendit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit) thekson:- në informatë e lexova se 309 qytetarë kanë pasur simptoma të helmimit, mirëpo para se me u bashkuar ujërat a janë bërë analiza se a është uji i pijes.

Arsim Dernjani thekson:- uji i cili merret nga burimi i poshtëm në të cilin e kemi rregulluar ne është në rregull, ndërsa burimi i ujit që është në vendin e quajtur te Kisha ka pasur problem që ndoshta mund të jenë edhe prej reshjeve atmosferike dhe prej disa drunjve të cilët janë për rreth. Instituti i ka përcjell rekomandimet.

Mehmet Ballazhi thekson:- kjo çështje pak është hiperbolizuar se ne të gjithë e dimë se është virus sezonal sepse e kemi diskutuar edhe me mjek por problem ishte se numri ka qenë i madh për një ditë dhe u bërë alarmante se për shkak të ujit. Edhe unë i kam pas dyshimet për durimit e ujit poshtë që merret por krejt e kundërta ka dal pra burimi te vendi i quajtur Kisha që gjithmonë është pijë aj ujë . Ne i kemi ndërmarr hapat me një herë por me bërë ndërtimin e dhomës së Klorifikimit dhe është në fazën përfundimtare. Problemi është menaxhuar në mënyrën më të mundshme prej institucioneve lokale dhe qendrore dhe ka pasur një bashkëpunim prej qytetarëve që me qetësi e kanë menaxhuar këtë situatë dhe është tejkaluar jashtëzakonisht mirë

Zaim Bela (Anëtar i më i vjetër i kuvendit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit) thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të parapri sipas agjendës.

11. Të ndryshme.

Zaim Bela (Anëtar i më i vjetër i kuvendit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit) thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Resul Suma thekson:- në mbledhjen e komitetit për komunitet të cilën e kemi pasur është kërkuar që me përcjell në kuvend çështjen që ti ipet një zyre OJQ Hendikosit . Është mirë që si komunë që pjesët e trotuareve ku janë zebrat me qenë e rrafshët për një karrocë pra drejtoria për shërbime publike ne ta merr parasysh. Kërkesë patën për pjerrinën që është te QKMF-ja me rregulluar.

Xhevahir Dernjani thekson:- ne gjithë e dimë që kompania “Bektelenka” i ka lënë shumë defekte gjatë punimeve të autostradës. Te vendi i quajtur qeshma e Hetemit po bëhet rrënim i madh i cili po vjen deri poshtë dhe po shkakton probleme por brenda mundësive buxhetore vitin e ardhshëm duhet të rregullohet. E përshëndes marrëveshjen e cila është bërë në mes të Ministrisë së Infrastrukturë për projektin për rrugën Ramuk deri te Kroi i fshatit Paldenicë , ndërsa për rrugën deri te Stanet duhet që në të ardhmen të rregullohet sepse mund të shfrytëzohet si qendër atraktive .

Hanumshahe Dibrani thekson:- kërkoj informacion për çështjen e ujit se deri ku kanë mbërri punimet

Resul Suma thekson:- kërkesë kam pas nga qytetarët për lokalet te kufiri se në bazë të hartës zonale a parashihen me prish.

Ibadete Kalisi thekson:- shtyllat te fusha e futbollit te shkolla e fshatit Seçishtë të rregullohen.

Sherif Berisha thekson:- unë jam që të rregullohen rrugët por mos të shkohet në atë mënyrë që kush do që vjen kryetar apo nënkryetar me i ndryshuar investimet por duhet të planifikohen dhe me u realizuar në bazë të planifikimeve

Mehmet Ballazhi thekson:- unë i kom ofruar zyre gjithë secilës OJQ që kanë aktivitet t'i kenë zyret te shtëpia e kulturës. Sa i përket zyrës për OJQ Hendikosin nga ky moment mund të pajisen me zyre për shkak se kushtet janë. Për çështje të trotuareve duhet të veprojmë për me ua rregulluar. Lokalet te kufiri dhe në qendër do të prishen vitin e ardhshëm por fillimisht do të identifikohen pronarët që kanë menaxhuar me ata lokale që një pjesë e tyre nuk po u dihet as adresa. Do të bëhet rrugë dhe një pjesë gjelbrim në mënyrë që me liruar pjesën e komunikacionit që po bëhet shumë e komplikime . Edhe në qendër ashtu siç parashihet me plan zhvillimorë do të veprohet.

Arsim Dernjani thekson:- sa i përket çështjes në vendin e quajtur qeshma e Hetemit për momenti nuk kemi mjete financiar dhe nëse do të kemi ndonjë donacion do të rregullohet në koritë ajo pjesa e kanalit. E kam shpallur tenderin për vendosjen e orëmatësve dhe punët janë duke u kryer.

Mehmet Ballazhi thekson:- te çështja e ujit sipas garancës të cilën na i ka dhënë CDI-ja dhe punëkryesi planifikojnë në muajin maj apo qershor , mirëpo problemi është te çështja e trafos për shkak se pasi e kanë instaluar është dashur me deinstalu për me bërë kërkesë për me marr licencë tjetër nga KED-si mirëpo në treg nuk ka kësi lloji të trafos dhe është dashur me bërë kërkesë në fabrikën ku bëhet prodhimi i kësi llojit të trafos. Sa i përket orëmatësve me që është interes i qytetarëve për me eliminuar keqpërdorimin i kemi ndarë 30 000 € që do të vendosën 200 orëmatës në pjesën nën magjistrale. Ne jemi për bashkëpunim pavarësisht pozitë apo opozitë dhe e kemi pasur kornizën afat mesme buxhetore dhe kemi diskutuar për projektet të cilat janë propozime nga dëgjimet publike dhe ata të cilat i kanë dhënë propozimet kanë kaluar dhe nuk jemi duke i orientuar në çdo anë sepse ju e dini çështjen për ndërtimin e shkollës në Lagje të Re se nuk kam ndonjë interes por duhet të zhvillohet edhe ajo pjesë. Po ashtu kemi marr veprime edhe për çështjen e ujit në fshatin Gorancë për shkak se ka qenë interes i qytetarëve. Ne jemi të interesuar edhe për rrugën Krivenik Gorancë por është një kosto bukur e madhe por varet sa do të na përkrah niveli qendrorë.

Sherif Berisha thekson:- unë kërkoj që mos të shkohet në avaze si më herët pra të mbetet një këshill. Sa i përket ujit shihet që ka probleme me dy vijat që vijnë njëra pre Currve dhe njëra prej Dimcës , jemi legjislativ dhe ekzekutiv e duhet të marrim hapa në këtë drejtim që me lëshuar ujin.

Hanumshahe Dibrani thekson:- a ekziston mundësia për me u ndarë në tri pjesë uji , njëra për Curr, njëra për Dimcë dhe një për Han të Elezit.

Mehmet Ballazhi thekson:- nuk kemi interes që me vepruar një anshëm me projekte sepse nuk kemi ndonjë interes. Sa i përket çështje së ndarjes së ujit as nuk ka nevojë për me ndarë për Dimcë as për Curr sepse Ligji mbi ujërat është Ligj i veçantë por kjo ka qenë politike më herët që mos ta hidhërojmë këtë apo atë por është dashur me u zgjidhur ky problem se as Dimca as Dërmjaku nuk munden me marr ujin qysh duan vetë por secili kemi dashur me një bashkëpunim me një mirëkuptim me vepruar në mënyrë që qytetarët mos me mbetur pa ujë.

Resul Suma thekson:- drejtorja e urbanizmit e ka përgatitur planin zhvillimorë, mirëpo te kufiri është mirë me shfrytëzuar për shkak se janë njëzetë lokale dhe njëzet familje varen prej atyre lokaleve dhe jam që të mbeten ata lokale.

Nexhmedin Daci thekson:- ajo pronë nuk është e jona, një pjesë është e rrugës dhe një pjesë është e AKP-së dhe kush për me dhënë leje prona duhet të jetë e komunës ose e pronarit privat. Të gjithë e dimë problemin e rrugës në atë pjesë që duhet ta shikojmë për me bërë zgjidhje . Pavarësisht këtyre gjërave ato lokale janë në gjendje katastrofë , nuk i paguajnë taksa askujt dhe nuk i japin llogari dhe kemi edhe ankesa nga kompania "Sharrcem", mirëpo ndoshta në të ardhmen mundet me u bërë një plan por duhet të bëhet më i mirë me standarde.

Sherif Berisha thekson:- a jeni duke punuar për çështjen e ndërtimeve të larta dhe duhet ë ndërmerret një hap në mënyrë që mos me na ikur investitorët për shkak se Ligji dhe rregulloret e parashohin që me u ndërtuar deri në pesë apo gjashtë kate.

Nexhmedin Daci thekson:- hartën zonale të komunës e kemi gati por fillimisht duhet të miratohet plani zhvillimorë komunal për shkak se është dokument bazik dhe aty janë të paraparë lartësitë. Problemin e kemi me këto banesate vjetra por do t'i shikojmë mundësit me dal me një propozim që me ju mundësuar pronarëve të vjetër ndërtimin e banesave përmes investitorëve me bërë ndërtime të reja në bazë të planeve rregulluese.

Zaim Bela (Anëtar i kuvendit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit) thekson:- sa i përket lokaleve është mirë që mos të luhet me kategoritë e dalura nga lufta edhe pse nuk e di si janë ato lokale dhe a nuk i përkas ndonjë familje që kam ndonjë veteran. Është mirë që të bëhet një plan për me i ndërtuar sepse ato kafiteri dhe shitore po e japin një pasqyrë të keqe dhe me ik pak më lartë dhe me liruar rrugën atje më poshtë dhe me ua dhënë nga një lokal. Duhet të shikohet mundësia ligjore se a ka të drejtë komuna me bërë një planë dhe me i përfshirë ato pesëmbëdhjetë familje. Sa i përket çështjes së ujit CDI-ja dhe kompanitë duhet të ndëshkohen për shkak se nuk i kanë kryer punimet me kohë . Në KEDS vetëm shkon e bënë kërkesën dhe vijën e ta vendosin orë dhe pse komuna me i shpenzuar 30 000 € për orëmatësit . A është shpallur në tender projekti i parku Isa Berisha.

Mehmet Ballazhi thekson:- te çështja e barakave te kufiri e kemi diskutuar edhe me persona të ndryshme dhe nëse dikush mundet me ditë vlerën e familjeve të dëshmorëve jam një prej atyre që jam pjesë e përbashkët e atyre dëshmorëve por kam pas fat mos me u vra në luftë dhe nuk jam dëshmor. Kur janë dhënë barakat aty janë dhënë me qëllim të caktuar për shkak se atëherë nuk kishte asnjë lloj kompensimi apo ndihmese për familjet e dëshmorëve dhe ju ka ndarë për me ju ndihmuar por kanë hyjë edhe persona të tjerë që kanë përfituar që nuk po mundemi me identifikuar që do të thotë që gjithsecili ka dashur me përfituar prej kësaj. Familjet e dëshmorëve dhe veteranët marrin një pagë pavarësisht se është e vogël por marrin një pagë. Qeveria e ka përcaktuar me Ligj se si duhet të trajtohen familjet e dëshmorëve, veteranët dhe të tjerët. Më kanë thënë edhe ndërkombëtarët por edhe një monitoruese që ishte gjatë zgjedhjeve që për herë të parë po vijë në Kosovë në Han të Elezit kam hyrë dhe krejt mirë më ka pëlqyer , qytetarët janë humanista dhe bashkëpunues por më e keqja ishte pamja e parë e hyrjes në kufij më la përshtypje shumë të keqe dhe e krijova një imazh të keq për Kosovën . Për mos me lënë përshtypje dhe imazh të keq aty nuk duhet të shkohet vetëm për përfitime personale.

Nexhmedin Daci thekson:-tenderi është shpallur për parkun dhe shumë shpejtë do të fillojnë punimet.

Sherif Berisha thekson:- kemi qenë si delegacion prej kuvendit të komunës në kompaninë Sharrcem pra kemi qenë të gjitha partitë dhe prej OJQ-së ka marr pjesë z.Visar Hasallari. Gjatë bisedave që kemi pasur kemi kaluar mirë dhe besoj që edhe kryetari do ta vazhdon bashkëpunimin. Gjatë takimit që kemi pasur kemi biseduar shumë tema por u bisedua edhe çështja e psikologut dhe duhet të iniciohen procedurat.


Hisni Luri thekson:- ne i kemi dërguar me shkrim kërkesë kompanisë “Sharrcem” për çështjen e psikologut.

Zaim Bela (Anëtari më i vjetër i kuvendit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit) thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.
Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:35

Procesmbajtësi

Avni Bushi



Anëtari më i vjetër i Kuvendit në cilësinë e Kryesuesit

